

VENDIM
Nr.29, datë 2.4.2010

**MBI KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SHA
(FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 1.1.2010 DERI MË 31.12.2010**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, 9 dhe 26 pika 1 të ligjit 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa ”A”, pika 2 të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, pikës V.1 të rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2010, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, mbi kontratën “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2010 deri më 31.12.2010”,

konstatoi se :

- Palët e kësaj kontrate, KESH sh.a./FPSH dhe OSSH /FPP, janë të licencuara nga ERE-ja, përkatësisht:

- “OSSH” sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.9, datë 25.1.2008, i ndryshuar.”.

- “KESH” sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 11, datë 23.6.2006, i ndryshuar.”.

- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe OSSH sh.a. (FPP) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.

- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

- Në kontratën tip të miratuar nga ERE-ja me vendim të ERE-s nr.72, datë 24.6.2008 “Për miratimin e kontratës tip për furnizimin me energji elektrike ndërmjet FPSH dhe FPP”, në pikën 15 përcaktohet se dokumentet mbështetëse të kredisë mund të kërkojnë në çdo kohë si në datën e hyrjes në fuqi të kontratës ose në çdo kohë më pas, si të tilla nuk është kusht i domosdoshëm për t’u kërkuar dhe përcaktuar termat e saj para apo në momentimin e miratimit nga Bordi.

- Kontrata e furnizimit me energji elektrike ndërmjet KESH sh.a./ furnizuesi publik me shumicë dhe OSSH sh.a. /furnizuesi publik me pakicë për periudhën 1.1.2009 deri më 31.12.2009 e miratuar me vendimin nr.55, datë 3.8.2009”, nuk përbën një vullnet të mirëfilltë të palëve, duke ditur që aksioneri që zotëron paketën kontrolluese të njëres prej palëve është ndryshuar në kuadër të privatizimit të OSSH sh.a.

Për sa më sipër evidentuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. deri në nënshkrimin e një kontrate midis tyre, për furnizimin me energji elektrike për vitin 2010, për marrëdhënien e furnizimit me energji elektrike të zbatojnë kontratën tip të furnizimit me energji elektrike të miratuar nga ERE-ja me vendimin nr.72, datë 24.6.2008 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike ndërmjet KESH sh.a./furnizuesi publik me shumicë dhe OSSH sh.a./furnizuesi publik me pakicë”, të ndryshuar, në nenin 8 pika 1, sipas vendimit nr.55, datë 3.8.2009.

2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a./FPSH tek OSSH sh.a./FPP është sipas vendimit nr.95, datë 15.12.2009 “Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit t’i njoftojë palët për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2010.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
1639

